



QENDRA HISTORIKE E FSHATIT VUNO

Fshati i Vunoit është ndërtuar në formën e një teatri në këmbët e malit të Çikës. Ai vlerësohet si një ndër fshatrat më interesante të jugut për shkak të vlerave të mëdha historike dhe urbanistike- arkitektonike. Vunoi shpallet Qendër Historike me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.30, datë 20.01.2016. Ai vihet në mbrojtje, për ruajtjen e këtyre vlerave, të cilat nëpërmjet restaurimit dhe rehabilitimit të vendbanimeve tradicionale, theksimit të traditave të zonës, do të sjellin rritjen e turizmit dhe zhvillimin ekonomik.



 Qendra Historike  Zonë e mbrojtur

